



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2918/prot
16

Tiranë më 18.12.2022

VENDIM

Nr. 56, Datë 17.11.2022

PËR

**“RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE MASTER
PROFESIONAL NË “PEDAGOGJI E SPECIALIZUAR SOCIALE”, NË FAKULTETIN E
SHKENCAVE SOCIALE, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 35, nenit 72, pika 1), nenit 73, pika 1) nenit 75, Statutit të Universitetit të Tiranës miratuar nga MASR – ja, me urdhërin nr. 816 datë 26. 12. 2018, nenit 91, nenit 92, udhëzimit nr. 1., datë 14.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, kreu IV “hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit”, si dhe materialit të paraqitur nga Rektori i UT-së me shkresën nr. 2918/2. Prot., datë 02.11.2022: “Mbi riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në Pedagogji e Specializuar sociale”. Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 17.11.2022,

VENDOSI:

- Të miratojë riorganizimin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Pedagogji e Specializuar Sociale (Arsim Special) nga 60 ECTS (kredite) në 120 ECTS (kredite), në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës,
- Të miratojë formën e diplomës për programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Pedagogji e Specializuar Sociale” (Arsim Special) nga 60 ECTS (kredite) në 120 ECTS (kredite) në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

